

## **Disa nga ndryshimet që do të sjellë Procesi i Bolonjës në Universitetet Shqiptare**

**Së pari**, studenti konsiderohet si një punonjës me 40 orë pune në javë dhe, si i tillë, ai do të plotësojë detyrat e tij në frekuentim e përgatitje. Në këtë proces, ai do të ndihmohet nga një pedagog kujdestar, i cili mban lidhje me studentët, si dhe nga gjithë pedagogët, të cilët janë të detyruar të zhvillojnë rregullisht konsultime.

**Së dyti**, marrja e një specialiteti në këto kurrikula e lë të lirë studentin të zgjedhë gjatë dhe mbas jetës universitare module dhe drejtime formuese sipas kërkesave të tregut.

P.sh.; një student që ka mbaruar një degë në shkencat teknike apo bujqësore mund të ndjekë Diplomën e Mësuesisë, etj.

**Së treti**, lëvizjet e studentëve nga një universitet në tjetrin, nga një shtet në tjetrin është një normë e shoqërisë së ardhme në hapësirën evropiane. Nga ky këndvështrim merr një rëndësi të veçantë integrimi kulturor dhe njohja e gjuhëve të huaja.

**Së katërti**, do të kryhet kontrolli i cilësisë në nivelin institucional, kombëtar e evropian në bazë të kriterëve dhe standardeve të caktuara. Ky kontrolli i cilësisë ndërgjegjëson nga njëra anë studentin dhe nga ana tjetër universitetet, të cilat janë të detyruara të ngrënë zyrat e vlerësimit dhe të vetëvlerësohen. Praktika e akreditimit të universiteteve është alternativa bazë e funksionimit të tyre.

## **Të rejat që sjell Procesi i Bolonjës në sistemin e kërkim zhvillimit në Universitetet Shqiptare**

**Së pari**, zbatimi i kësaj reforme kërkon një ristrukturim administrativ të institucioneve formuese e shkencore. Mund të justifikohet mbajtja e një institucioni si shërbim kombëtar (statistika, meteologjia, veterinarja, etj.), si qendër e studimeve të avancuara "par excellence" ose si qendër e studimeve albanologjike. Në të kundërt, institutet e shumta dhe sistemi i dispersisë së tyre bëhet dhe në fakt është bërë një barrë shoqërore.

**Së dyti**, përafrimi i universiteteve tona me ato evropiane në bazë të Procesit të Bolonjës krijon mundësi dhe hapësira të reja në sistemin kërkim zhvillim. Krijimi i ciklit të dytë në arsimin e lartë, d.m.th. prania e studentëve që vazhdojnë studimet për Master dhe e atyre që mbrojnë gradën Doktor pranë Departamenteve, rrit ndjeshëm dhe në mënyrë reale kontigjentin e studiuesve në institucionet arsimore. Tashmë pranë Departamenteve krijohet një fuqi e papaguar fizike dhe mendore.

**Së treti**, misioni i bashkëpunimit midis universiteteve sipas Procesit të Bolonjës, krijon mundësi të reja për arsimin, si një e mirë publike në kuadrin e transferimeve teknologjike për ekonominë e tregut. Fuqizimi intelektual i universiteteve i bën këta të fundit të gëzojnë një feedback pozitiv në fuqizimin financiar dhe e kundërta.